

# AKT-THEMELIMI

## I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date 18.03.1996, Ministria e Financave, ne baze te Ligjit Nr.7926, date 20.4.1995, vendosi :

1. Te krijohet shoqerine anonime "Shtepia Botuese Enciklopedike" TIRANE.

2. Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete, botim dhe tregtim libra dhe revista enciklopedike.

3. Shoqeria do te kete seline e saj ne qytetin e Tiranes.

4. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 6.000.000 leke, nga e cila vlere e truallit eshte 363.200 leke, i ndare ne 6.000 aksione, me vlere nominale 1.000 leke.

5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.

6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :

1. Adem Jakllari
2. Zana Gusho
3. Dhurata Bogdani

7. Ndertimi organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.

8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themelues.

**DREJTORI I DREJTORISE SE SHOQERIVE PUBLIKE**



**BERZH PIRANIAN**

# STATUT

## I

### SHOQERISE ANONIME

Ne baze te dispozitave te ligjit Nr.7926, date 20.4.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", me autorizim te Ministrit te Financave Z.Berzh Piranian, Drejtor i Drejtorise te Shoqerive Publike nenshkruan statutin e shoqerise anonime si me poshte :

#### Neni 1

Shoqeria anonime formohet nga transformimi i ish-ndermarrjes shteterore Shtepia Botuese Enciklopedike.

Shoqeria e krijuar ne kete menyre emerohet Sh.A. "Shtepia Botuese Enciklopedike" Tirane.

Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Tiranes.

#### Neni 2

Objekti i shoqerise eshte ; botim dhe tregtim libra dhe revista enciklopedike.


Shoqeria, brenda cageve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje çdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejteperdrejte ose terethore me objektin e saj. Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive te reja, krijimin e sipermarrjeve te tjera dhe pjesmarrjen ne sipermarrje te tjera si brenda shtu dhe jashte vendit pa cenuar objektin e shoqerise.

#### Neni 3

### KAPITALI THEMELTAR-AKSIONET

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 6.000.000 leke, nga e cila vlere e truallit eshte 363.200 leke. Ai eshte i ndare ne 6.000 aksione te se njejtës kategori, te cilat zoterohen teresisht nga shteti.

Vlere nominale e aksionit eshte 1.000 leke.



## Neni 4

### SHITJA E AKSIONEVE NE RASTIN E PRIVATIZIMIT

Aksionet e shoqerise mund t'u shiten personave fizike e juridike shqiptare vetem ne rastin e nje vendimi te marre nga Ministri i Financave per privatizimin e shoqerise nepermjet bonove te privatizimit dhe/ose lekeve te privatizimit

Personat e huaj, fizike e juridike, mund te blejne aksione te shoqerise vetem ne rastet dhe ne masen e caktuar nga Ministri i Financave. Shlyerja e aksioneve nga personat e huaj, fizike e juridike, behet vetem me para ose me anen e kontributeve ne natyre per qellime teknologjike.

Ky nen nuk zbatohet per shoqerite qe veprojnene sektoret e naftes, minierave dhe energjise elektrike, aksionet e te cilave shiten sipas legjislacionit perkates te privatizimit te seciles prej tyre.

## Neni 5

### ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese te shoqerise jane :

1. Keshilli mbikqyres
2. Drejtori i pergjithshem

## Neni 6

### KESHILLI MBIKQYRES

1. Keshilli mbikqyres perbehet 3 anetare.  
Anetaret e keshillit mbikqyres emerohen :

2/3 nga Ministri i Financave

1/3 nga Ministri i Kultures Rinise dhe Sporteve.

II. Kohezgjatja e funksionit te tyre eshte 4 vjet. Anetaret e Keshillit mbikqyres jane te gjitha te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga titullari i organit qe i ka emeruar vetem per shkage te perligjura.

III. Anetaret e keshillit mbikqyres jane persona fizike. Ata nuk mund te jene te punesuar ne shoqeri.

IV. Ne se nje ose disa vende te anetareve te keshillit te mbikqyrjes mbeten bosh per shkak vdekjeje, shkarkimi ose doreheqje, zevendesimi duhet te kryhet jo me vone se tre muaj.

Anetari i keshillit mbikqyres, i emeruar me zevendesim te nje anetari tjetër, perfundon mandatin e paraardhesit.

V. Anetaret e keshillit mbikqyres nuk mund te bejne pjese ne me shume se tre keshilla mbikqyres te shoqerive anonime qe e kane seline ne territorin e Republikes se Shqiperise.

VI. Anetaret e keshillit mbikqyres te moshes mbi 65 vjeç nuk mund te jene me shume se nje e treta e numrit te pergjithshem ne mbyllje te ushtrimit te çdo viti financiar. Nese kjo perqindje tejkalohet anetari me i moshuar do te konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

VII. Ky keshill do te funksionoje deri ne momentin e shitjes se aksioneve. Pastaj shoqeria do funksionoje ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

### Neni 7

## **KRYETARI DHE ZEVENDESKRYETARI I KESHILLIT MBIKQYRES**

Keshilli mbikqyres zgjedh ndermjet anetareve te tij nje kryetar dhe nje zevendeskryetar te cilet ngarkohen te mbledhin keshillin dhe te drejtojne diskutimet. Ata emerohen per te gjithë kohen e mandatit te tyre ne keshillin mbikqyres dhe jane te rizgjedhshem.

Keshilli mbikqyres mund te emeroje nje sekretar jashte anetareve te tij.

### Neni 8

## **VENDIMET E KESHILLIT**

Keshilli mbikqyres mblidhet sa here qe e kerkon interesi i shoqerise, me thirrjen e kryetarit, ose ne mungese te tij, te zevendeskryetarit.

Kryetari duhet te therrase keshillin mbikqyres, brenda pesembedhete diteve, kur drejtori ose nje e treta e anetareve te keshillit mbikqyres i paraqitin atij nje kerkese te motivuar per kete qellim.

Nese kerkesa mbetet pa pergjigje, atehere autoret e saj mund te therrasin keshillin, duke i permendur rendin e dites.

Ne parim thirrja duhet te behet tre dite perpara, me leter, telegram, teleks ose telefaks. Por ajo mund te behet me goje dhe pa afat ne qofte se anetaret e keshillit mbikqyres e pranojne ate.

Çdo thirrje duhet te tregojë çështjet kryesore te rendit te dites.

Mbledhja e keshillit mbikqyres behet ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjeter te treguar ne thirrje.

II. Keshilli mbikqyres mund te marre nje vendim te vlefshem, ne qofte se jane te pranishme jo me pak se gjysma e anetareve te keshillit.

Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem. Ne rast votash te barabarta, ajo e kryetarit eshte percaktuese.

III. Keshilli mbikqyres mban nje regjister te pjesmarrjes ne mbledhjen e tij, i cili nenshkruhet nga anetaret e pranishem ne mbledhje.

IV. Vendimet e keshillit mbikqyres evidentohen me procesverbale te hartuara ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi, nga kryetari i seances dhe nga nje anetar i keshillit ose, ne mungese te kryetarit, nga jo me pak se dy anetare te keshillit.

Kopjet e ketyre procesverbaleve vertetohen nga kryetari keshillit mbikqyres, zevendes kryetari dhe nga drejtori i pergjithshem.

## Neni 9

### KOMPETENCAT E KESHILLIT MBIKQYRES

Keshilli mbikqyres ushtron kontroll te perhershem per administrimin e shoqerise nga drejtori i pergjithshem i saj dhe i jep ketij te fundit autorizimin paraprak per kryerjen e operacioneve qe nuk mund te kryhen nga drejtori i pergjithshem pa autorizimin paraprak te keshillit mbikqyres.

Keshilli mbikqyres emeron drejtorin e pergjithshem.

Ai autorizon marreveshjet e parashikuara ne nenin 13 te ketij statuti.

Ai autorizon drejtorin e pergjithshem te kryeje veprimet dhe te marre masat e parashikuara ne nenin 12 te jetij statuti.

Keshilli mbikqyres ka te drejte te kryeje ne çdo kohe verifikime dhe kontrole qe ai i çmon te pershtatshme, dhe kerkon te njihet me dokumentet qe ai i gjykon te nevojshme per permbushjen e dyteres se tij.

Drejtori i paraqet raport keshillit mbikqyres te pakten nje here ne tre muaj.

Brenda tre muajve nga data e mbylljes se ushtrimit financiar, drejtori duhet t'i paraqese keshillit mbikqyres llogarite vjetore me qellim verifikimi dhe kontrolli tyre nga ky i fundit.

Keshilli mbikqyres shqyrton llogarite vjetore dhe raportin vjetor te paraqitur nga drejtori i pergjithshem dhe i paraqit per kete raport Drejtorise te Shoqerive Publike.

Keshilli mbikqyres mund t'i ngarkoje njerit ose disa anetareve te tij çdo mandat te posaçem per nje ose disa objekte te caktuara.

## Neni 10

### SHPERBLIMI I ANETAREVE TE KESHILLIT MBIKQYRES

Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres do te behet ne perputhje me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.348 date 3.7.1995 "Per keshillat mbikqyres te shoqerive shteterore".

Masa e shperblimit caktohet nga aksionmbajttesi i vetem.

## Neni 11

### DREJTORI I PERGJITHSHEM


1. Drejtori i pergjithshem emerohet nga keshilli mbikqyres kur per te jane dakord jo me pas se 3/4 e anetareve te ketij keshilli. Ai mund te zgjidhet qofte ndermjet personave te shoqerise, qofte edhe jashte te punesuarve te saj.

Nese nje anetar i keshillit mbikqyres emerohet drejtor mandati i tij ne keshill merr fund me hyrjen e tij ne funksion.

Nje person nuk mund te emerohet drejtor ne me shume se nje shoqeri.

Drejtori mund te shkarkohet nga keshilli mbikqyres vetem per shkaqe te perligjura. Ne rastin kur i interesuari ka lidhur nje kontrate punesimi me shoqerine, shkarkimi i tij nga funksioni i drejtorit nuk eshte shkak per zgjidhjen e kesaj kontrate.

II. Drejtori emerohet per nje periudhe kohe prej 4 vjetesh. Ne rastet te pushimeve dhe te mungesave te tjera te zgjatura, keshilli mbikqyres ben menjehere zevendesimin e tij.



Drejtori eshte i riemerueshem. Ai nuk mund te jete ne moshen mbi 65 vjeç.

Drejtori qe mbush 65, quhet zyrtarisht i shkarkuar dhe zevendesohet menjehre.

Menyra dhe masa e shperblimit te drejtorit caktohen nga keshilli mbikqyres ne aktin e emerimit te tij.

## Neni 12

### KOMPETENCAT E DREJTORIT

I. Drejtori ka kompetenca te plota ndaj te treteve per te vepruar ne emer te shoqerise ne çfardo rrethane, me perjashtim te kompetencave qe i jane caktuar shprehimisht keshillit mbikqyres nga ligji dhe nga ky statut.

Ne marredhenie me te tretet shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e drejtorit edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e shoqerise, perveç rastit kur shoqeria provon se te tretet e dinin qe akti i drejtorit kapercente objektin e shoqerise dhe vepronte me keqbesim, ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt, duke pasur parasysh faktin se vete shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Kufizimet e kompetencave te drejtorit te caktuara ne statut duhet te respektohen nga te tretet.

Megjithate, ne cilesine e masave te rregullimeve te brendshme te shoqerise, por qe nuk u kundervihet te treteve, veprimet dhe masat e meposhtme kryhen vetem me autorizim te keshillit mbikqyres.

- percaktimi dhe ndryshimi i programit te veprimtarise afatshkurter, afatmesme dhe afatgjate te shoqerise.

- kryerja e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e buxhetit fillestar te shoqerise.

- hapja e veprimtarive ose e njesive te reja, shkrirja ose bashkimi dhe mbyllja teresisht e pjeserisht e veprimtarive dhe njesive te shoqerise.

- blerja, shkembimi dhe shitja e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshem te shoqerise.

- themelimi i shoqerive ose pjesmarrja ne shoqeri te tjera te krijuara, ose per t'u krijuar.

- marrja e huave afatmesme, afatgjata, dhënia e dorezanive ose e garancive të tjera kur këto të fundit tejkalojnë veprimtaritë e zakonshme të shoqërisë.

- negociimi, përfundimi a ndryshimi i çdo kontrate me afat mbi 3 vjet ose për një shumë detyrimesh vjetore mbi dy miliona leke ;

- përcaktimi i kriterëve për diskutimin, përfundimin dhe ndryshimin e kontratës së punësimit me punonjësit;

- në përgjithësi marrja e vendimeve dhe masave që e kapërcejnë veprimtarinë e zakonshme të shoqërisë dhe që janë të tilla që mund të sjellin ndryshime në objektin e shoqërisë.

II. Drejtori i përgjithshëm mund të delegojë një pjesë të kompetencave të tij, që ai i gjykon të dobishme tek një ose disa persona të tjera që kryejnë funksione teknike në drejtimin e shoqërisë.

III. Drejtori i përgjithshëm përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretet.

Emertimi dhe pushimi i tij duhet të publikohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Aktet, me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të treteve, duhet të mbajnë nënshkrimin e drejtorit të përgjithshëm, ose të personit të autorizuar rregullisht nga drejtori për këto akte.

Eshtë e detyrueshme që çdo marrëdhënie ndërmjet drejtorit të përgjithshëm dhe keshillit mbikqyres të regjistrohet ose të pasqyrohet në procesverbal.

Marrëdhëniet, brenda shoqërive përcaktohen me rregullore të veçanta të cilat miratohen në keshillat mbikqyres të këtyre shoqërive.

### Neni 13

## MARREVESHJET NDERMJET SHOQËRISE DHE DREJTORIT OSE NJE ANETARI TË KESHILLIT MBIKQYRES

Çdo marrëveshje ndërmjet shoqërisë dhe drejtorit të përgjithshëm ose një anetari të keshillit mbikqyres, qoftë e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë, duhet t'i nënshtrohet autorizimit paraprak të keshillit mbikqyres.

Kjo dispozitë është e zbatueshme edhe për marrëveshjet ndërmjet shoqërisë dhe një shoqërie tjetër, kur një anetar i keshillit mbikqyres është edhe anetar i keshillit mbikqyres të shoqërisë tjetër, me të cilën propozohet të lidhet marrëveshja.



Dispozitat e mesiperme nuk jane te zbatueshme per marreveshjet qe kane te bejne me veprimet rrjedhese te shoqerise qe kryhen ne kushtet normale.

Drejtori ose anetari mbikqyres i interesuar duhet te njoftoje keshillin mbikqyres sapo merr dijeni per nje marreveshje, per te cilen zbatohen kerkesat e ketij neni te satutit. Anetari i keshillit mbikqyres i intersuar nuk merr pjese ne votimin per dhenien e autorizimit.

#### Neni 14

### **EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR**

Kontrolli ushtrohet nga nje ose dy eksperte te autorizuar, te cilet emerohen nga aksionmbajtesi i vetem dhe qe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin.

#### Neni 15

### **USHTRIMI FINANCIAR**

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te çdo viti.

Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin kohen nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar gjer me 31 dhjetor.

#### Neni 16

### **INVENTARI-LLOGARITE VJETORE**

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat ligjore.

Ne mbyllje te ushtrimit, drejtori harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin financiar.

Drejtori pergatit gjithshtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara per te ardhmen, ngjarjet me te rendesishme qe kane ndodhur gjate periudhes nga data e mbylljes te ushtrimit financiar deri ne daten e hartimit te ketij raporti, si dhe veprimtarite e shoqerise ne fushen kerkimore-shkencore.

## Neni 17

**REZULTATI I USHTRIMIT DHE CAKTIMI I FITIMEVE**

Rezultati i ushtrimit percaktohet si diference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit, duke perfshire te keto te fundit amortizimet dhe provizionet.

Nga fitimet e ushtrimit te pakesuara, kur eshte rasti, me humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5 perqind per te krijuar rezerven e domosdoshme.

Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme pushon se geni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin nje te dhjeten e kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur per nje arsye cfardo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nen nje te dhjeten e kapitalit.

Nga fitimet e ushtrimit te pakesuar, kur eshte rasti, me humbjet e meparshme, shoqeria do te heqe jo me shume se 85 perqind per krijimin e rezervave per zhvillim.

Shuma e fitimeve te mbetura pas heqjes per krijimin e rezervave te permendura me siper perfaqeson dividendin, i cili derdh ne buxhetin e shtetit.

Duke perjashtuar rastin kur eshte vendosur zvogelimi i kapitalit, nga fitimet e ushtrimit nuk behet asnje heqje dhe asnje derdhje dividenti, ne qofte se kapitalet e veta jane ose do te beheshin me te vogla se shuma e kapitalit themeltar plus shumen minimale te kerkuar per rezerven e domosdoshme.

Ne qofte se ekziston nje humbje, kjo mbartet per t'u perfshire ne fitimet e ushtrimit te ardhshme deri ne shuarjen e saj.

Caktimi (shperndarja) e fitimeve dhe menyra e mbulimit te humbjeve behen me vendim te ministrit te financave dhe cilesine e tij si aksionmbajtes i vetem ne shoqeri.

## Neni 18

**EMERIMI I ANETAREVE TE PARE TE KESHILLIT MBIKQYRES**

Si anetare te pare te keshillit mbikqyres emerohen :

- |                      |                  |
|----------------------|------------------|
| - Z. Adem Jakllari   | banues ne Tirane |
| - Z. Zana Gushe      | banues ne Tirane |
| - Z. Dhurata Bogdani | banues ne Tirane |



**Neni 19**

Te gjitha atributet e asamblese se pergjithshme te parashikuara nga ligji Nr.7638 date 19.11.1992 qe nuk jane shprehur ne kete statut do te ushtrohen nga ministri i financave me cilesine e aksionmbajtesimit te shtetit ne shoqeri.

**Neni 20****EMERIMI DHE SHKARKIMI I DREJTORIT TE PARE**

Ne nje afat prej 6 muajsh nga data e regjistrimit te shoqerise drejtori i ish ndermarrjes shteterore do te jete i emeruar zyrtarisht Drejtor i Pergjithshem i Shoqerise dhe do te jete pergjegjes per ruajtjen e pasurise te saj.

Gjate ketij afati ai mund te shkarkohet vetem nga Ministri i Financave dhe per shkaqe te perligjura mbi bazen e propozimeve te Drejtorise te Shoqerive Publike ose te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise.

Hartuar ne *B. Z.*...1996 me 6 kopje te njejta.

**DREJTORI****I****DREJTORISE SE SHOQERIVE PUBLIKE****BERZH PIRANIAN**